

Përmbledhje e Dokumentit të Treguesve Kyç të Performancës për IdentiTek SH.A

Viti 2024

Gjatë vitit 2024, IdentiTek SHA aprovoi Treguesit Kyç të Performancës (KPI), një dokument strategjik për shoqërinë. KPI-të e aprovura janë matësit kryesorë të ecurisë së punës së institucionit, janë metrikë që IdentiTek përdor për të matur performancën në mënyrë efektive.

Ky dokument, përfshin Misionin, i cili përcakton qëllimin themelor të Identitek, duke përfshirë arsyen e ekzistencës së tij, çfarë bën dhe kujt i shërben dhe Vizionin, i cili përshkruan gjendjen e dëshiruar të ardhshme, pra aspiratat afatgjata të shoqërisë.

Në bazë të misionit dhe vizionit, IdentiTek ka hartuar një “Hartë Konceptuale” të funksionit të tij, ku përfshihen qëllimet dhe objektivat e shoqërisë. Këto objektiva bëhen të matshme nëpërmjet treguesve kyç të performancës, të cilët janë përfshirë në këtë hartë dhe të cilët janë indikatorë objektivash. Këta indikatorë masin në mënyrë direkte rezultatin e punës së IdentiTek SHA në prodhimin e shpërndarjen e dokumenteve biometrike dhe mirëfunksionim në përmbushje të misionit dhe me synim arritjen e vizionit të shoqërisë.

KPI-të shërbejnë si një udhërrëfyes për punën e përditëshme dhe ndihmojnë shoqërinë të qëndrojë e fokusuar në objektivat e saj strategjike. Janë vlerësime cilësore dhe sasiore dhe janë përzgjedhur me kujdes për të lidhur aktivitetet (çfarë bëjmë); me objektivat (mënyrat që përdorim për të arritur qëllimin); dhe së fundmi me qëllimin kryesor (çfarë synojmë).

Më poshtë, është një përmbledhje e këtyre elementeve:

Misioni

IdentiTek ka si mision të ofrojë shërbime të një niveli të lartë sigurie, me integritet, të specializuar dhe në përmirësim të vazhdueshëm për prodhimin e dokumenteve biometrike në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, për shtetasit shqiptarë brenda dhe jashtë vendit dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri.

Vizioni

Vizioni i IdentiTek është të jetë lider në fushën e shërbimeve të identifikimit biometrik dhe printimit të sigurt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përtej tij. Ne synojmë të ndërtojmë një standard dhe reputacion të padiskutueshëm për cilësi dhe profesionalizëm, duke u angazhuar në inovacionin e vazhdueshëm dhe ofrimin e zgjidhjeve të avancuara teknologjike.

Qëllimi

IdentiTek ka si qëllim kryesor të ofrojë shërbime profesionale, të besueshme dhe efikase për prodhimin e dokumenteve biometrike, duke përfshirë të gjithë hapat nga aplikimi tek shpërndarja e tyre, për shtetasit shqiptarë brenda e jashtë vendit dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri.

IdentiTek ka tre objektiva kryesorë për të përmbushur qëllimin:

Objektiva

- I. **Mbajtja e një standardi të lartë për ofrimin e shërbimit në kohë e në mënyrë profesionale:** Këtu përfshihet respektimi i afateve të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike si edhe ofrimi i shërbimeve me nivel të lartë ndaj qytetarëve gjatë çdo procesi aplikimi për pajisjen me dokumente biometrike.
- II. **Inovacioni Teknologjik:** Të qëndrojnë në krye të zhvillimeve teknologjike në fushën e prodhimit të dokumenteve të identifikimit biometrik, duke siguruar që kompania të jetë në gjendje të përdorë teknologji në mënyrë efikase për të garantuar sigurinë dhe integritetin e produkteve dhe shërbimeve të saj.
- III. **Anëtarësimi i Shqipërisë në ICAO PKD:** Të arrijë njohjen e pasaportës biometrike shqiptare dhe të kryejë shkëmbimin periodik të të dhënave me Drejtorinë e Celësive Publikë (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

Harta Konceptuale e KPI-ve, IdentiTek SHA

Qëllimi Kryesor	
Të ofrojë shërbime profesionale, të besueshme dhe efikase për prodhimin e dokumenteve biometrike, duke përfshirë të gjithë hapat nga aplikimi tek shpërndarja e tyre, për shtetasit shqiptarë brenda e jashtë vendit dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri	
Objektiva	Indikatorë
<p>I. Mbajtja e një standardi të lartë për ofrimin e shërbimit në kohë e në mënyrë profesionale</p> <p>Këtu përfshihet respektimi i afateve të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike si edhe ofrimi i shërbimeve me nivel të lartë ndaj qytetarëve gjatë çdo procesi aplikimi për pajisjen me dokumente biometrike.</p>	1. Kryerja në kohë e prodhimit dhe shpërndarjes së Letërnjoftimit Elektronik brenda dhe jashtë vendit
	2. Kryerja në kohë e prodhimit dhe shpërndarjes së pasaportave biometrike brenda dhe jashtë vendit
	3. Kryerja në kohë e prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri
	4. Përmirësimi i bazës ligjore, Rregulloreve e Urdhrave të brendshëm për të përmirësuar e standartizuar praktika
	5. Mbajtja e pasqyrave financiare të shoqërisë sipas standardeve ndërkombëtare të Raportimit Financiar
<p>II. Inovacioni Teknologjik</p> <p>Të qëndrojnë në krye të zhvillimeve teknologjike në fushën e prodhimit të dokumenteve të identifikimit biometrik, duke siguruar që kompania të jetë në gjendje të përdorë teknologji në mënyrë efikase për të garantuar sigurinë dhe integritetin e produkteve dhe shërbimeve të saj të saj.</p>	6. Marrja dhe ruajtja e certifikimit ISO (Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim)
	7. Numri i projekt propozimeve të hartuara me synim zhvillimin e aplikacioneve apo produkteve të reja
<p>III. Anëtarësimi në ICAO PKD Njohja e pasaportës biometrike shqiptare nga Drejtoria e Celësive Publikë (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO)</p>	8. Regjistrimi dhe anëtarësimi i IdentiTek në ICAO PKD